

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Gjilani – Raporti komunal

Tetor 2009

Gjilani në shifra

Popullsia	Gjithsej	126,906
	Shqiptarë	89%
	Serbë	9%
	Të tjerë	2%
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	515 km/2
	Numri i fshatrave	63
Shkollimi	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	10.7%
	Fillore/e mesme e papërfunduar	40.2%
	E mesme	33.5%
	Shkollë e lartë	7.3%
	Universitet	2.8%
	Nr. i nxënësve	26,731
	Nr. i mësimdhënësve	1,602
	Nr. i shkollave të mesme	7
	Nr. i shkollave fillore	22
	Nr. i çerdheve	3
	Hapësira shkollore në m2 (statistikat e fundit shtator 2007)	53,975
	Shëndetësia	Spital
Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare		1
Qendra të Mjekësisë Familjare		32
Nr. i mjekëve		77
Papunësia	Gjithsej	47.6%
	Meshkuj	28.8%
	Femra	74.6%
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	77,413
	Përqindja e fuqisë punëtore e angazhuar në sektorin publik	2,577
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	13,258,107
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	2,200,000
	Të hyrat tjera (Euro)	11,058,107
Shpenzimet e realizuara (2008) (në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion)	Gjithsej (Euro)	11,903,686 (95%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	2,217,100 (85%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	9,686,486 (98%)
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	PDK	34%
	LDK	20%
	LDD	15%
	AKR	14%
	AAK	9%
	ORA	2%

	PD	1%
	Tjera	2%
Kryetarët e Komunës 2000-2009	2000-2002: Lutfi Haziri (LDK) 2002-2007: Lutfi Haziri (2002-2004) (LDK) dhe Xhemajl Hyseni (2004-2007) (LDK/LDD) 2007-2009: Qemajl Mustafa (PDK)	

Shkurt për Gjilanin

Gjilani i themeluar nga Bahti Beg Gjinolli në shekullin e XIX-të, tani përbën njërën nga shtatë qendrat kryesore rajonale në territorin e Kosovës. Tani nuk mund të gjendet asnjë gjurmë nga qyteti i vjetër i Gjilanit, pasi që e tërë pjesa e vjetër është shkatërruar. Nëpër Gjilan kanë kaluar lumi Mirushë dhe Stanishorkë. Nuk është vetëm Prishtina qyteti i cili i ka mbuluar lumenjtë e vet. Për këtë fakt njihet edhe Gjilani. Mirëpo, për dallim nga Prishtina, Gjilani ende i vuan pasojat e mbulimit të shtratit të lumit Mirushë dhe Stanishorkë. Nga mbulimi i këtyre dy lumenjve dhe kthimi i tyre në kanal për ujëra të zeza, sot Gjilani i tëri kundërmon nga erërat e kanalizimeve. Andaj, sfidë kryesore për çdo udhëheqës të kësaj komune edhe më tutje mbetet eliminimi i kundërmimit të erërave.

Problemet aktuale

Problemet më të mëdha aktuale me të cilat përballen qytetarët e Gjilanit janë:

- Kundërmimi i ujërave të zeza,
- Komunikacioni,
- Mungesa e parkingjeve,
- Humbja e tokës bujqësore,
- Zhvillimi ekonomik.

Kundërmimi i ujërave të zeza. Qyteti ka një problem të madh: kundërmimi nga ujërat e zeza. Kundërmimi vie si pasojë e mbulimit të shtratit të lumenjve Mirusha dhe Stanishorka dhe derdhja e ujërave të zeza në to. Kundërmimi ndihet më shumë në mëngjes dhe në mbrëmje, atëherë kur pushon komunikacioni dhe gazrat që lëshohen nga puna e përditshme e makinerisë. Kundërmimi përshkon tërë qytetin, por më shumë kanë problem banorët që shtrihen përkaj rrugës për në fshatin Malishevë, si dhe banorët në pjesën periferike që njihet si “Zabeli i Sahitagës”. Zgjidhja e këtij problemi ka qenë premtim i çdo kryetari të komunës që nga viti 2000, mirëpo konkretisht asgjë nuk është realizuar. Edhe kryetari aktual i Gjilanit pati premtuar se brenda mandatit të tij qeverisës do të zgjidhet ky problem, mirëpo vetëm tani kanë filluar punimet në një pjesë të qytetit. Sipas projektit për zgjidhjen e problemit të shtratit të lumit Mirusha, zgjidhja në tërësi e këtij problemi do të kushtojë rreth 5 milion euro. Kurse për fazën e parë të punimeve janë ndarë 1.5 milion euro, ku me pjesën më të madhe të mjeteve ka kontribuar Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Me këto mjete do të bëhet vetëm hapja e kanalit për qarkullimin e ujërave të zeza që derdhen në këtë lum, por problemi nuk do të zgjidhet në tërësi nëse nuk instalohet edhe impianti për pastrimin e këtij uji që derdhet në dalje të qytetit. Qytetarët nuk kanë besim në përfundimin me sukses të këtij projekti, pasi që fillimet e punimeve janë bërë në prag të fushatës zgjedhore. Ky projekt është zvarritur që nga viti i kaluar.

Komunikacioni. Problem tjetër në qytetin e Gjilanit është komunikacioni i dendur. Si pasojë e rrugëve të ngushta, mungesës së rrugëve dytësore, ndërtimeve pa leje dhe një planifikimi të dobët urban, në qytetin e Gjilanit vërehet një kaos urbanistik. Organet përgjegjëse të komunës janë munduar të bëjnë zgjidhje për këtë problem por pa sukses. Është ndërtuar një rreth-rrotullim afër stacionit policor (përballë Hotel “Kristal”), por i cili realisht nuk ka mundur të bëjë një zgjidhje për këtë problem. Rrethi nuk ka mundur të bëhet më i gjerë si pasojë e rrugës së ngushtë dhe disa herë është ndërruar madhësia e këtij rrethi deri sa ka marrë formën përfundimtare. Në qytet, në dy udhëkryqet ku bëhet komunikacioni më i dendur janë të vendosur semaforët, të cilët asnjëherë nuk funksionojnë. Policia shumë rrallë duket në këto dy udhëkryqe për drejtim të komunikacionit. Në fillim të këtij viti, Komuna e Gjilanit zbatoi një projekt ku dy rrugët kryesore të qytetit, ato që lidhin qytetin e Gjilanit me Prishtinën, u bënë një-anësore, kurse rrugët dytësore u vunë në funksion për qarkullim dhe u vendosën shenjat e sinjalizimit vertikal. Por ky projekt nuk funksionoi dhe pas protestave të pronarëve të bizneseve dhe qytetarët, komuna e ktheu komunikacionin në gjendjen e përparshme. Për këtë projekt të dështuar komuna ka shpenzuar rreth 100,000 euro. Para disa muajve, komuna ka financuar sinjalizimin horizontal të rrugëve të qytetit, mirëpo për pak kohë këto sinjalizime kanë filluar të shlyhen si pasojë e ngjyrës së dobët me të cilën janë punuar. Andaj problem i cili duhet të adresohet në të ardhmen nga qeverisja komunale edhe më tutje mbetet komunikacioni në qytet.

Parkingjet. Krahas komunikacionit të dendur dhe rrugëve të ngushta, problem është edhe mungesa e parkingjeve në qytet. Në tërë qytetin e Gjilanit mund të gjenden 3-4 parkingje private me pagesë, kurse në një pjesë të madhe të qytetit nuk ka fare. Problemi më i madh vërehet në rrugën ku janë përqendruar bizneset – rruga nga Teatri i Qytetit e deri në dalje të kësaj rruge për Prishtinë, por edhe në rrugën nga Xhamia e Madhe e deri tek Shkolla e Lartë Pedagogjike. Lokalet janë të vendosura shumë afër rrugës kryesore dhe trotualet janë aq të ngushta, sa që nuk lënë vend as për këmbësorë, e as për parking. Shpeshherë ndodh që trotualet të bllokohen nga automjetet dhe njerëzit të ecin në rrugë.

Shkatërrimi i tokave bujqësore. Gjilani, si komunë që shtrihet në pjesën a Anamoravës, ka pasur toka të shumta bujqësore, të cilat para shumë vitesh janë mbjellë kryesisht me duhan. Në këtë komunë ka funksionuar edhe Industria e Duhanit, ku kultivuesit kanë mundur që t’i shesin produktet e tyre. Mirëpo kjo tani ka ndryshuar në tërësi. Tokat bujqësore që shtrihen në magjistralen Gjilan – Bujanovc janë shndërruar në pompa të benzinës dhe biznese të ndryshme kanë ndërtuar depot e tyre. Edhe tokat bujqësore në pjesën e magjistrales Gjilan – Ferizaj janë shndërruar në toka ndërtimore. I tërë ky degradim i tokës bujqësore nuk ka shërbyer për zbutjen e papunësisë, por në të kundërtën: ndërtimet në tokat bujqësore nuk kanë sjellë punësim apo zhvillim ekonomik.

Zhvillimi Ekonomik. Problem madhor në komunën e Gjilanit, ashtu si në tërë komunat e Kosovës, është i lartë i papunësisë. Shkalla e papunësisë në këtë komunë është 47.6%. Me këtë shifër të papunësisë, Gjilani radhitet komuna e 14-të në krahasim me komunat tjera të Kosovës. Mirëpo nëse e krahasojmë Gjilanin me qendrat e tjera komunale kryesore (Ferizaj, Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë, Pejë, Prizren), del se Gjilani radhitet e dyta pas Mitrovicës për nga numri i të papunëve. Numri i të papunëve të regjistruar në Entin Komunal të punësimit ka shkuar duke u

rritur nga viti në vit dhe momentalisht të papunë të regjistruar janë 36,814 individë. Kurse 1,173 familje (me 4.981 anëtarë) marrin ndihma sociale nga Qendra për Punë Sociale (MPMS). Deri në fund të viteve '80 në Gjilan kanë qenë aktive një numër i madh i ndërmarrjeve shoqërore industriale. Pas largimit të punëtorëve shqiptarë nga vendet e tyre të punës nëpër këto ndërmarrje dhe humbja e tregut të këtyre ndërmarrjeve, shumë punëtorë mbetën pa punë dhe shumë prodhues mbetën pa treg për të shitur produktet e tyre. Në Gjilan ka qenë aktive Industria e Duhanit, ku prodhuesit e duhanit nga kjo komunë, por edhe nga komunat tjera të Kosovës i kanë shitur prodhimet e tyre të duhanit. Përveç Industrisë së Duhanit në këtë komunë ka funksionuar edhe Gurëthyesi më i madh në Kosovë "Morava e Binçës"; Fabrika e Baterive; Fabrika e Tekstilit; Fabrika e radiatorëve, etj. Pas privatizimit të këtyre ndërmarrjeve, nuk u arritën rezultatet e dëshiruara, si hapja e vendeve të reja të punës dhe zhvillimi ekonomik.

Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Zgjedhjet e 17 nëntorit 2007, nxorën fitues **Qemajl Mustafën** nga PDK, i cili me **13.164 vota** apo **37.01%** u detyrua që të angazhohet edhe për tri javë tjera në zgjedhjet e balotazhit ku për kundër-kandidat kishte Lirije Kajtazin nga LDK. Përfundimisht z. Mustafa e siguroi postin e kryetarit të komunës pas zgjedhjeve të balotazhit ku fitoi shumicën prej **67.4%** apo **13.906 vota**.

Premtimet kryesore të Qemajl Mustafës gjatë fushatës parazgjedhore ishin:

Tab. 1. Premtimet dhe realizimi i tyre

Premtimet	Realizimi i premtimeve
Se do të angazhohet në zgjidhjen e problemit të ujërave të zeza, ku nga ujërat e zeza dhe nga lumi Mirusha i tërë qyteti i Gjilanit kundërmon erë kanalizimi;	Problemi i ujërave të zeza vazhdon t'i shqetësojë qytetarët edhe tani pas afro dy viteve të qeverisjes së kryetarit Qemajl Mustafa. Në shtator 2009 komuna ka filluar në një pjesë të qytetit që të punojë në zgjidhjen e këtij problemi. Për këtë qëllim janë ndarë 1.5 milion euro, mirëpo i tërë projekti parashihet që do të kushtojë rreth 5 milion euro. Andaj problemi i ujërave të zeza do të jetë problem për tu zgjidhur edhe në qeverisjen e ardhshme komunale.
Se do të zgjidh problemin e arsimtarëve të cilët nuk kanë mundur që të futen në lista të pagave;	Qeverisja e kaluar komunale kishte shkaktuar një pështjellim në arsim duke futur në punë mësimdhënës të tepërt dhe duke mos mundur që t'i përfshij ata në listën e pagave të MASHT-it. Kryetari Mustafa ka arritur ta zgjidh këtë problem dhe në shtator të vitit të kaluar 153 mësimdhënës janë përfshirë në listën e pagave.
Do të ndërtojë dy shkolla fillore në qytetin e Gjilanit, një shkollë të mesme dhe do të vazhdojë punimet në shkollën e filluar në Zabel;	Me mjete të MASHT-it është ndërtuar një shkollë fillore në lagjen "8" të Gjilanit, dhe një shkollë tjetër brenda qytetit; gjithashtu MASHT ka financuar edhe shkollën në Zhegër. Shkolla në "Zabel" është përfunduar, mirëpo ende nuk është lëshuar në përdorim.
Do të bëjë ndryshime rrënjësore në menaxhimin e arsimit;	Sa i përket menaxhimit në fushën e arsimit, Gjilani ka shënuar përparim. Udhëheqësi i drejtorisë së

	arsimit, konsiderohet si nj nga menaxherët më të aftë në këtë drejtori që nga pas lufta.
Orët mësimore në shkollat e Gjilanit do të bëhen orë 40 minutëshe, e jo siç është tani 25 minutëshe; do të rris bashkëpunimin në mes mësimdhënësve dhe prindërve të nxënësve;	Edhe pse janë ndërtuar tri shkolla të reja, orët mësimore nuk janë bërë 40 minutëshe në të gjitha shkollat, për shkak se Gjilani ka nevojë edhe për më tepër hapësira shkollore. Gjatë vitit 2007, në Gjilan tri shkolla fillore mbanin mësim në katër ndërrime; kurse tri shkolla të mesme mbanin mësim në tri ndërrime. Tani në asnjë shkollë nuk ka mësim në katër ndërrime, por ka ende shkolla që mbajnë mësim në tri ndërrime. Kjo e pamundëson mbajtjen e orëve 40 minutëshe.
Do të riaktivizoj shkollën këshillimore për femrat e reja;	Nuk është bërë asgjë në këtë drejtim dhe komuna nuk ka shumë njohuri se për çfarë premtimi bëhet fjalë.
Se do të siguroj ujë të pijshëm dhe të bollshëm për qytetin e Gjilanit.	Gjilani ka përmirësuar furnizimin me ujë të pijshëm, por mbetet ende shumë për tu bërë me qëllim që të sigurohet furnizim i pandërprerë me ujë të pijshëm.
Do të siguroj qarkullim më të mirë në trafik;	Komuna ka tentuar që të bëj një ri-rregullim të komunikacionit në trafik, projekt i cili ka dështuar pasi që nuk është pranuar nga qytetarët. E tëra që ka arritur të bëj komuna ka qenë ndërtimi i rreth-rrotullimit afër stacionit policor, por i cili nuk ka ndikuar në zhblokimin e komunikacionit. Sinjalizimi horizontal i bërë para disa muajve tani ka filluar të shlyhet si pasojë e ngjyrës së dobët të përdorur.
Do të modernizoj administratën dhe do të rris efikasitetin; njerëzit e administratës do të përdorin teknologjinë bashkëkohore dhe shërbimet do të kryhen shpejt; do të digjitalizoj administratën	Administrata komunale ka një zyrë për pritjen e qytetarëve e cila është e rregulluar mirë dhe funksionon shumë mirë. Këtë vit, Komuna ka bërë zgjerimin e hapësirave të ofiqarisë, që ka ndikuar në uljen e radhëve dhe vendosjen e rendit. Mirëpo administrata komunale e Gjilanit është ende larg asaj që është premtuar nga Qemajl Mustafa – siç është edhe digjitalizimi i administratës.
Do të mundohet që në shëndetësi të rris numrin e personelit për kokë banori, numër i cili konsiderohet si i ulët; do të siguroj që lista esenciale e barnave të jetë complete.	Përkundrazi, numri i personelit shëndetësor në mjekësinë primare, e cila është në kompetencë të komunës, ka shkuar duke u zvogëluar. Nga 328 punonjës shëndetësorë që ishin në 2007, ky numër ka rënë në 320 gjatë vitit 2008, kurse në vitin 2009 është 318. Pra dhjetë pozita më pak në sektorin e shëndetësisë primare në Gjilan, e jo më shumë siç kishte premtuar Qemajl Mustafa.
Do të krijoj hapësira të reja të gjelbëruara	Investimi më madhor në këtë drejtim ka qenë ripunimet në parkun qendror të qytetit dhe zgjerimi i tij. Gjithashtu edhe krijimi i rreth-rrotullimit përballë stacionit policor ka mundësuar krijimin e një "oaze" të vogël të gjelbëruar në mes të komunikacionit. Rreth-rrotullimi dhe parku i qytetit kanë qenë të mirëmbajtura mirë, çka ka ndikuar që gjelbërimi në këtë pjesë të mos vshket. Por nuk ka hapësira tjera shtesë të gjelbëruara.

Do të zgjerohet tri arteriet kryesore rrugore të Gjilanit, siç janë daljet për Ferizaj, Prishtinë dhe Dardanë	Nuk është bërë asgjë në drejtim të përmbushjes së këtij premtimi.
Do të angazhohet që zonat në fshatin Stanishor dhe Kalaja e Pograxhes të shpallen si zona të mbrojtura	Stanishori tani do t'i kaloj komunës së Novobërdës, ashtu siç parashihet me Pakon e Ahtisaarit. Mirëpo deri më tani nuk është bërë asgjë që Stanishori të futet në përkujdesje institucionale për sa kohë ka qenë pjesë e Gjilanit. Kalaja e Pograxhes tani së fundmi është përfshirë nën përkujdesje institucionale.
Do të angazhohet që Lagjja e re e krijuar në qarkoren Prishtinë-Dardanë të ketë kanalizim dhe rrjet të ujësjellësit	Për këtë lagje, e cila ka marrë emërtimin lagjja "Fidanishtë", është hartuar plani urbanistik dhe me këtë plan pritet që kjo lagje të bëhet me infrastrukturë të nevojshme, mirëpo deri atëherë nuk ka asgjë konkrete në realizimin e këtij premtimi.
Do të kujdeset që rinisë t'i krijohet Shtëpinë e Rinisë; do të investoj në kulturë dhe në teatrin e qytetit	Nuk është përmbushur në tërësi ky premtim. Gjilani nuk ka shtëpi të Rinisë. Teatri i Qytetit është rinovuar gjatë vitit të kaluar dhe 11 aktorë të rinj të Teatrit të Gjilanit janë përfshirë në listën e pagave. Ansambli të Valleve i është financuar në tërësi pjesëmarrja në një festival në Turqi.

Zgjedhjet lokale në Gjilan

Menjëherë pas mbarimit të luftës më 1999, kryetar i Gjilanit ishte emëruar Iljaz Kurteshi. Këtë pozitë si i emëruar kryetar komune Iljaz Kurteshi e mbajti deri në zgjedhjet e para lokale në tetor të vitit 2000, kur votuesit i dhanë shumicën qeverisëse LDK-së dhe Lutfi Haziri u zgjodh kryetar komune. Lutfi Haziri i fitoi zgjedhjet lokale edhe në vitin 2002, post të cilin e mbajti deri në fund të 2004 kur mori postin e Ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal. Në vend të tij u vendos Xhemajl Hyseni, i cili pas përplasjeve që ndodhen në LDK, ku ky subjekt u nda në dy parti të ndryshme, Xhemajl Hyseni kaloi në LDD dhe qeverisi me komunën deri në fund të mandatit më 2007. Zgjedhjet e 17 nëntorit 2007, fitues nxorën Qemajl Mustafën nga PDK. PDK arriti të fitoj zgjedhjet lokale edhe pse kishte një rënie në vota prej 544 votash, por përkundër kësaj rënie në këto zgjedhje PDK fitoi një vend më shumë në Kuvend Komunal. Kësaj i ndihmoi edhe dobësimi i LDK-së, së cilës iu nda një pjesë e anëtarësisë dhe kaloi në partinë e re LDD, si dhe suksesi i AKR-së, si parti që për herë të parë garonte në zgjedhje lokale. Kuvendi Komunal i Gjilanit sërish do të ketë 41 ulëse edhe në mandatin e ardhshëm qeverisës.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Gjilanit.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	10398	11	12167	13	11623	14
LDK	24479	27	21589	23	6894	9
AAK	2159	2	2126	2	3124	4
LDD	-	-	-	-	5101	6
AKR	-	-	-	-	4836	6
ORA	-	-	-	-	917	1
PD	-	-	-	-	641	1

PQLK	560	1	-	-	-	-
DCC	-	-	824	1	-	-
OCA	-	-	1350	1	-	-

Në tri palë zgjedhjet e gjertanishme lokale përqindja e pjesëmarrjes së votuesve në zgjedhje ka qenë e ndryshme, por gjithnjë në rënie. Në zgjedhjet e para lokale të vitit 2000 pjesëmarrja në votime ishte 79.3%, në zgjedhjet e dy viteve më vonë pjesëmarrja ra në 54.14%, kurse në 2007 ajo ra në 43.79%. Në zgjedhjet e nëntorit 2009 të drejtë për të votuar kanë 87,427 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Gjiilan në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007
Votues me të drejtë vote	52413	79075	77465
Vota valide	39122	42.809	33928
Përqindja e daljes në votime	79.3%	54.14%	43.79%

Buxheti i Komunës

Buxheti i përgjithshëm i komunës së Gjiilanit nuk ka pasur një rritje të vazhdueshme nga viti në vit. Buxhetet e komunës për vitet 2005-2008 kanë qenë më të vogla se sa buxheti i vitit 2004. Rritjen më të madhe buxheti komunal e ka këtë vit, pra më 2009, i cili është rritur për afro 3 milion euro. Kategoria e cila ka shënuar rritje gjithnjë që nga viti 2003, është kategoria “rroga dhe mëditje”, kjo për arsye se numri i punonjësve në shërbimin civil komunal dhe pagat e tyre ka shkuar gjithnjë duke u rritur.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Rezervat	Gjithsej
2009	8,139,317	1,433,268	344,400	119,000	3,222,122	-	13,258,107
2008	6,463,057	1,612,520	373,000	119,000	1,954,192	-	10,521,769
2007	6,237,871	1,344,943	367,204	92,000	1,611,364	-	9,653,382
2006	6,185,733	1,496,570	285,230	208,000	2,380,453	-	10,555,986
2005	5,866,279	1,714,961	227,700	47,050	2,655,240	-	10,511,230
2004	5,597,485	2,181,940	-	-	3,850,832	100,000	11,730,257
2003	4,438,603	1,857,771	-	-	2,541,428	300,611	9,138,413

Për vitin 2009 buxheti i komunës së Gjiilanit është 13,258,107 €, prej të cilave 16.5% janë të hyra vetanake të komunës. Të hyrat vetanake të komunës kanë shënuar rritje, por jo një rritje të përgjithshme nga viti në vit, pasi që në vitin 2007 dhe 2006 është vërejtur një rënie e të hyrave vetanake. Sa i përket arkëtimit të të hyrave vetanake, komuna e Gjiilanit gjatë vitit 2008 ka arritur që të hyrat vetanake ti arkëtoj në masën 106.2% në krahasim me planifikimet (në krahasim me komunat tjera Gjiilani zë vendin e 15 me efikasitet në arkëtimin e të hyrave vetanake).

Investimet kapitale

Siç tregon tabela më sipër (tabela 4), për investime kapitale që nga viti 2003 e deri më 2009, komuna e Gjilanit ka pasur të ndara 18,215,631 €. Gjatë vitit 2008 dhe 2009, në Gjilan është investuar në projekte të ndryshme, si nga komuna, por edhe nga niveli qendror, sidomos në rrugë dhe shkolla. Tabela më poshtme tregon disa nga projektet më me rëndësi që janë kryer gjatë këtyre dy viteve në komunën e Gjilanit:

Tab.5.: Investimet kapitale në Gjilan gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Investitori	Shuma e Projekteve
2008	Ndërtimi i dy shkollave fillore në qytet, dhe një në fshatin Zhegër	MASHT, Komuna	€1,365,295
2008	Rikonstruktimi i rrugë Ponoshec-Zhegoc	MTPT	€455,870
2008	Asfaltimi i rrugës në Livoq të Epërm	MTPT	€249,659
2009	Rregullimi i Varrezave të Dëshmorëve	Komuna	€150,000
2009	Halla Sportive	Komuna	€167,582

Komuna e Gjilanit ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për tri vitet në vazhdim (2010-2012). Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Gjilanit do të ketë në dispozicion **14,449,919 €** për investime kapitale. Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Gjilanit për mandatin e tij qeverisë katërvjeçar do të ketë në dispozicion rreth **20 milion €** për investime kapitale.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Gjilanit 2010-2012

Buxheti	2009	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	13,258,107	14,518,256	15,548,749	16,078,889
Të hyrat vetanake në €	2,200,000	3,000,000	3,718,038	3,825,289
Investimet kapitale në €	3,222,122	3,952,931	4,983,424	5,513,564

Administrata komunale

Në sektorin publik komunal në Komunën e Gjilanit në vitin 2009 janë të punësuar 2,588 persona, në administratë, arsim dhe shëndetësi. Siç shihet edhe nga tabela e mëposhtme (tabela 7), në dy vitet e fundit në Gjilan është rritur numri i të punësuarve në sektorin publik për 34 veta. Gjilani zë vendin e 13 në Kosovë në krahasim me komunat e tjera për numrin e punëtorëve shëndetësor për kokë banori (2.5 punëtor shëndetësor për 1.000 banorë); kurse në arsim zë vendin e 3 (1.6 mësimdhënës për 100 banorë).

Rritja e numrit të të punësuarve në sektorin publik është bërë vetëm në kuadër të administratës komunale. Momentalisht në administratën komunale të Gjilanit janë të punësuar 258 punonjës. Sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 10/43 i 3 dhjetorit 2008, Gjilani ka administratë të mbingarkuar me punonjës dhe

nevojitet që të largojë staf deri në atë pikë sa administrata e Gjilanit të ketë 189 punonjës (1 punonjës për 750 banorë).

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Gjilanit sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	2588 ▲
2008	2577 ▲
2007	2354
2006	2568 ▲
2005	2530
2004	2631 ▲
2003	2475 ■

Komuna e Gjilanit dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sa i përket përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale dhe marrëdhëniet e komunës me nivelin qendror, Komuna e Gjilanit në masë të madhe i ka përmbushur obligimet ligjore. Kuvendi Komunal i Gjilanit ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta, ashtu siç parashihet edhe me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Në këto 11 mbledhje, Kuvendi Komunal ka miratuar 6 rregullore komunale. Kuvendi Komunal i Gjilanit vazhdimisht e njofton Ministrinë e Pushtetit Lokal për seancat dhe i dërgon ftesë për pjesëmarrje në to. Komiteti për Buxhet dhe Financa (KPF) i cili është komitet obligativ dhe detyrat e tij janë ndër të tjera edhe rekomandimi i rendit të ditës për Kuvendin Komunal, është takuar 10 herë. Përveç KPF-së, Gjilani ka formuar edhe 6 komitete tjera legislative, por të cilat janë më pak aktive.

Sa i përket tubimeve publike që komuna ka mbajtur me qytetarë, Gjilani gjatë tërë vitit 2008 ka mbajtur dy tubime publike, aq sa kërkohen edhe me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Mirëpo pjesëmarrja e qytetarëve në këto tubime publike nuk ka qenë e kënaqshme, edhe pse zyrtarët për informim janë përpjekur që të informojnë publikun për tubimet publike duke dërguar shpallje nëpër radio dhe duke ngjitur pllakate anë e kënd qytetit.

Sa i përket qasjes në dokumente zyrtare, gjatë vitit 2008 në zyrën e arkivit të Komunës së Gjilanit janë dorëzuar tri kërkesë, dy prej të cilave kanë marrë përgjigje pozitive, kurse njëra është ende në procedurë. Kurse gjatë tërë vitit 2008, në Komunën e Gjilanit është dorëzuar vetëm një peticion, tregues për një shkallë të ulët të angazhimit qytetar në këtë komunë.

Komuna e Gjilanit ende nuk ka regjistër të plotë të pronës publike komunale dhe një gjë të tillë është duke e bërë aktualisht. Gjilani është njëra ndër shtatë komunat e cila raportet e Auditorit të Brendshëm i ka të publikuara edhe në ueb faqe. Komuna e Gjilanit ka përfaqësim në katër borde të ndërmarrjeve publike.

Komuna e Gjilanit ka një ueb faqe mjaftë të pasur me informacione rreth qytetit. Është e mirëmbajtur/azhurnuar në baza të rregullta kohore. Është e pajisur me

informacione të mjaftueshme, aq sa një qytetari të Gjilanit do t'i nevojiteshin rreth aktiviteteve të komunës dhe më gjerë. Informacionet më të cekëta në ueb faqe janë lidhur me projektet e realizuara komunale dhe prokurimi. Në krahasim me komunat tjera, uebfaqja e Komunës së Gjilanit zë vendin e parë për nga informacionet e plasuara dhe për nga mirëmbajtja në baza të rregullta.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Gjilanit (www.gjilani-komuna.org)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave ¹
Ballina	5
Organizimi komunal	3.67
Shërbimet komunale	3.2
Info rreth qytetit	4.5
Projektet komunale	2.75
Lajme& lajmërim	3
Harta e faqes	3
Kontakt	5
Gjuhët	5
Fusha për kërkim	5
Tjera informacione shtesë	3
Baza Ligjore	4
Mesatarja totale	3.93
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	1

Gjendja në arsim

Në Komunën e Gjilanit funksionojnë 32 institucione arsimore: shtatë shkolla të mesme (duke llogaritur edhe paralelet e ndara), 22 shkolla fillore dhe tri çerdhe. Deri në fund të vitit 2007, kur për herë të fundit është bërë matja e hapësirës shkollore në m², Gjilani kishte 53,975 m² hapësirë shkollore. Gjilani është njëra ndër komunat që më së shumti ka probleme me hapësirë shkollore. Deri në fillim të vitit shkollor 2008/2009 në Gjilan kanë qenë tri shkolla të cilat kanë zhvilluar mësim në katër ndërrime. Tanimë nuk ka shkolla që zhvillojnë mësim në katër ndërrime, mirëpo ende në pesë shkolla zhvillohet mësim në tri ndërrime. Kjo ka ndikuar që orët mësimore të jenë më të shkurta se 40 minutëshe. Gjatë vitit 2008 dhe 2009 në Komunën e Gjilanit janë duke u ndërtuar tri shkolla fillore, dy në qytet dhe një në fshatin Zhegër, si dhe është planifikuar që të ndërtohet edhe një shkollë e mesme, punimet për të cilën priten të fillojnë së shpejti.

Gjendja në shëndetësi

Pasi që Gjilani është edhe qendër regjionale, në këtë qytet funksionon edhe shëndetësia sekondare, përmes spitalit Regjional të Gjilanit, i cili menaxhohet nga Ministria e Shëndetësisë. Në këtë spital i kryejnë shërbimet mjekësore qytetarët e

¹ (rradhitja nga 1 deri 5) 5 - shkëlqyeshem, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

komunave Gjilan, Kamenicë, Viti dhe Novobërdë. Gjatë këtyre viteve, Spitali Regjional i Gjilanit ka qenë njëri ndër spitalet që është menaxhuar më dobët në krahasim me spitalet tjera regjionale, por për këtë përgjegjësi bie mbi Ministrinë e Shëndetësisë.

Komuna menaxhon me shëndetësinë primare. Përveç Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, në Gjilan funksionojnë edhe 32 institucione shëndetësore (QMF dhe punkte shëndetësore). Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare është e mirëmbajtur në nivel të kënaqshëm. Gjilani ka një numër të vogël të punëtorëve shëndetësorë për kokë banori. Gjilani zë vendin e 13 në Kosovë në krahasim me komunat e tjera për numrin e punëtorëve shëndetësor për kokë banori (2.5 punëtor shëndetësor për 1.000 banorë).

Shoqëria civile

Edhe pse Gjilani është një nga qendrat më të mëdha komunale, shoqëria civile në këtë komunë nuk është mjaft aktive, sikurse në qendrat e tjera të Kosovës. Organizata më e madhe jo qeveritare është Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (KCIC). Kjo organizatë ka zbatuar shumë projekte që kanë të bëjnë me monitorimin e qeverisjes komunale apo ofrimin e alternativave për një qeverisje më të mirë. Organizatë tjetër aktive është edhe OJQ “Paqja me Natyrën” e cila është e orientuar shumë më shumë drejt problemeve që kanë të bëjnë me mjedisin dhe e cila ka shtyrë shumë projekte përpara në agjendën komunale.

Shoqata e gruas “Liria” është organizatë e cila merret me çështjen e grave dhe përkujdesjes sociale. Kjo shoqatë merr një financim të konsiderueshëm nga ana e komunës për implementimin e projekteve sociale. ANP (Aksioni për Ndërtimin e Paqes) është organizatë tjetër aktive. Aktivitetet kryesore të ANP-së janë fuqizimi i rinisë dhe pajtimi ndëretnik. Në këto dy fusha ANP ka pasur disa aktivitete edhe në komunën e Kamenicës dhe Novobërdës. Në procesin e decentralizimit, ANP ka bashkëpunuar ngushtë me komunën dhe nivelin qendror në organizimin e debateve edhe në pjesët ku banon minoriteti serb.

Mediat lokale

Në komunën e Gjilani funksionojnë dy televizione lokale (TV MEN dhe TV Vali) dhe katër radio lokale (Radio Energy, Radio Victory, Radio Star dhe Radio MegaVox). Përderisa TV Vali ka program të rregullt si dhe transmeton rregullisht programe informative me tematikë nga regjioni i Gjilanit, TV MEN nuk ka program të rregullt dhe shpeshherë ka ndërprerje të transmetimeve. Këto dy televizione janë të pavarura komerciale.

Sa i përket radiove, Radio Energy është më aktive në mbulimin e ngjarjeve që ndodhin në kuadër të komunës, organizim të debateve dhe, në bazë kontratës që ka me Komunën e Gjilanit, bën transmetimin e mbledhjeve të Kuvendit Komunal. Komuna dërgon njoftime dhe shpallje në radiot dhe TV-të e qytetit, mirëpo sipas medimeve komuna nuk i kryen me rregull obligimet financiare ndaj këtyre medimeve.

Në përgjithësi, Gjilani ka media të pavarura dhe profesionale në punën e tyre. Po ashtu, Gjilani e mbulojnë edhe gazetat më të mëdha ditore përmes korrespondentëve të tyre të përhershëm në terren.

Rendi dhe ligji në Komunën e Gjilanit

Nga 1 janari 2008 deri me 31 dhjetor 2008, në Komunën e Gjilanit, kanë ndodhur **3,744** raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsej **74 shkelje të natyrave të ndryshme**. Për nga numri i popullsisë, Gjilani radhitet komuna e 4 në krahasim me komunat e tjera, kurse sa i përket numrit të rasteve të shkeljes së rendit dhe ligjit kjo komunë radhitet e 6 (sipas statistikave të Policisë së Kosovës për 2008). Rastet më të rënda të shkeljes së rendit dhe ligjit kanë të bëjnë me aksidente (ku Gjilani radhitet e treta komunë në Kosovë për numrin më të madh të aksidenteve), si dhe vjedhje (sërish Gjilani zë vendin e tretë). Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Gjilan (2008)

Lloji i shkeljes	Numri i rasteve	Renditja në krahasim me komunat tjera për numrin e rasteve të ndodhura
Aksidente	849	3
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	210	4
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	37	6
Vjedhje e pyjeve	21	7
Incidente lidhur me pronën	195	5
Vjedhje	1423	3
Abuzime seksuale	10	7
Shkaktim të dëmtimeve trupore	268	4
Kërcënime	96	6
Mashtrime	50	6
Vrasje	8	10

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifatatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifatatimore të tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Në bazë të kësaj rregulloreje të UNMIK-ut, Kuvendi Komunal i Gjilanit ka adaptuar Rregulloren Komunale për Caktimin dhe Aplikimin e Tatimit në Pronë në Komunën e Gjilanit për 2007. Kjo rregullore është vazhduar me vendim të kryetarit të komunës edhe për vitet 2008 dhe 2009. Sipas kësaj rregulloreje, Komuna e Gjilanit është ndarë në pesë zona kadastrale, të cilat edhe kanë vlera të ndryshme të tregut, kurse zona e I është e ndarë edhe në dy nënzona kadastrale. Tabela më poshtë paraqet llojet e pronës, normat tatimore dhe çmimin e tregut për atë pronë.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Gjilanit

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	Norma tatimore				
	0.08%	0.08%	0.17%	0.12%	0.08%
I	500* €	450 €	1,000 €	400 €	150 €
Ia	475 €	400 €	900 €	350 €	150 €
Ib	450 €	375 €	800 €	300 €	150 €
II	400 €	350 €	600 €	250 €	150 €
III	400 €	325 €	500 €	200 €	150 €
IV	-	250 €	400 €	200 €	100 €
V	-	200 €	200 €	150 €	50 €

* Vlera e tregut për metër katror.

Kostoja për biznese

Në mars të vitit 2009, Kuvendi Komunal i Gjilanit ka adaptuar një rregullore të re për taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale. Me këtë rregullore, janë ulur ndjeshëm kuotat për pagesë me rastin e marrjes së lejes së punës. Tabela më poshtë pasqyron disa nga bizneset më të përhapura dhe taksën vjetore për punë:

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	800 €
Kompanitë e sigurimit	800 €
Mishtoret	120 €
Agjensionet turistike	120 €
Hotelet	400 €
Motelet	240 €
Supermarketet-Hipermarketet	240 – 400 €
Vetëshërbimet - Minimarketet	140 €
Kafeteritë	120 €
Restorant	200 €
Telekomunikimit	240 €
Depot	160 – 280 €
Autoshkollat	
Gurëthyesit	480 €
Pompat e benzinës	400 €
Ndërmarrjet ndërtimore	240 – 280 €
Veprimtaritë e pavarura zejtare	20 - 240 €
Veprimtaritë profesionale	50-320 €
Ndërmarrjet prodhuese	80-400 €

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 - raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa - të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 "Jeta në Kosovë", www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report - Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës - janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
13. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
14. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
15. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
16. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.